
	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina</p>	 PRISHTINA
---	---	--

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-63779/24 dt. 17.05.2024, të kërkuësve/ pronarëve Naser Krasniqi, Ismet Krasniqi dhe Burim Potera, që të gjithë nga Prishtina, me investitor “Al-Trade Center” shpk me seli në Glllogoc, ne rr. “Jasharajve”, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me përfaqësues Sokol Gashani nga Glllogoci, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, “Linda Premium Residence”, përkatësisht Ndërtesa “H” e ndërtuar në kuadër të parcelave ndërtimore “E-4-1” dhe “E-4-2”, të bllokut urban “E4”, të Tërësisë “E”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim” në Prishtinë, në rr. “Daut Pllana” dhe “Shkupi”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 23.09.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET kërkuësve/ pronarëve Naser Krasniqi, Ismet Krasniqi dhe Burim Potera, që të gjithë nga Prishtina, me investitor “Al-Trade Center” shpk me seli në Glllogoc, ne rr. “Jasharajve”, pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me përfaqësues Sokol Gashani nga Glllogoci, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-63779/24 dt. 17.05.2024, përdorimi i kompleksit me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, “Linda Premium Residence”, përkatësisht Ndërtesa “H” me etazhitet 2B+S+P+7, e ndërtuar sipas “Vendimit të Lejes Ndërtimore” 05 Nr. 351/02-159337/17 dt. 14.12.2017, të lëshuar nga kjo drejtori, në parcelen kadastrale nr. 10171-5, ZK Prishtinë, në kuadër të parcelave ndërtimore “E-4-1” dhe “E-4-2”, të bllokut urban “E4”, të Tërësisë “E”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim” në Prishtinë, i lëshuar nga kjo drejtori, në emër të Naser Krasniqi, Demir Krasniqi, Isak Krasniqi, Hazbi Krasniqi, Ismet Krasniqi, Ramadan Makolli, Bekim Nika, Hasan Potera, Sajmir Konushevcij dhe Bekim Xhemajli.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Daut Pllana” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, 17, 19, 21, 23, 25 dhe 27 në Prishtinë, dhe në rrugën “Shkupi” ku kanë dalje hyrjet me numrat: 176 në Prishtinë, dhe e njehta do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njërive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Kërkuesit/ pronaret Naser Krasniqi, Ismet Krasniqi dhe Burim Potera, që të gjithë nga Prishtina, me investitor "Al-Trade Center" shpk me seli në Glllogoc, ne rr. "Jasharajve", pn., me certifikate të biznesit ARBK 811167924, dhe me përfaqësues Sokol Gashani nga Glllogoci, me kërkesën me 05 Nr. 351/02-159337/17 dt. 14.12.2017, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksin me ndërtesa shumëbanesore me afarizëm, "Linda Premium Residence", përkatësisht Ndërtesa "H" me etazhitet 2B+S+P+7, e ndërtuar në kuadër të parcelave ndërtimore "E-4-1" dhe "E-4-2", të bllokut urban "E4", të Tërësisë "E", të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parces kadastrale nr. 10171-5, ZK Prishtinë, ndërtuar sipas "Vendimit të Lejes Ndërtimore" 05 Nr. 351/02-159337/17 dt. 14.12.2017, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, e Komunës së Prishtinës në emër të Naser Krasniqi, Demir Krasniqi, Isak Krasniqi, Hazbi Krasniqi, Ismet Krasniqi, Ramadan Makolli, Bekim Nika, Hasan Potera, Sajmir Konushevcu dhe Bekim Xhemajli, si dhe pranuar teknikisht nga komisioni përkatës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Spektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-45114/24 dt. 25.04.2024, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimet të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Inspektimi i sigurisë nga zjarri; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Labinot Bashota; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Ilir Babaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujës-jellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Astrit Salihu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Abaz Kelmendi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Artan Dashi; Raportin e përfundimit të punëve të sigurisë nga zjarri, nga mbikqyrësi Valon Ajazi; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licensuar Xhavit Fetahu me nr. të licensës 75;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujës-jellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, dhe instalimet e makineris, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në dëshminë e pronësisë për parcelën kadastrale nr. 10171-5 ZK Prishtinë, pronarë/posedues të kësaj parcele kadastrale janë Naser Krasniqi, Ismet Krasniqi dhe Burim



Potera, përderisa posedues të lejes ndërtimore janë bashkëpronarët: Naser Krasniqi, Demir Krasniqi, Isak Krasniqi, Hazbi Krasniqi, Ismet Krasniqi, Ramadan Makolli, Bekim Nika, Hasan Potera, Sajmir Konushevcu dhe Bekim Xhemajli. Në ndërkohë, bazuar në aktin noterial "Kontratë për ndarjen (fizike) të bashkëpronësisë dhe riorganizimin e pjeseve ideale në bashkëpronësi", i përpiluar te Noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë, me Nr. LRP-së.13213/2019 dhe Nr. REF.2741/2019, të datës 11.10.2019, bashkëpronarë të parcelës kadastrale nr. 10171-5 ZK Prishtinë, janë vetëm Naser Krasniqi, Ismet Krasniqi dhe Burim Potera nga Prishtina, dhe rrejdhimisht certifikata e përdorimit lëshohet në emër të të njëjtëve.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesën shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-63779/24 DT. 23.09.2024**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu
B. Vllasaliu

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi

